

# Bujtinat

## Lodges

**COVID-19 Udhëzime**  
**COVID-19 Guidelines**



Gusht/August 2021

# Hyrje

Ndërkohë që e gjithë Industria Turistike po shkon drejt një hapjeje graduale, krijimi i një sërë udhëzimesh, të cilat mund të zbatohen në një sërë aktivitetesh dhe eksperiencash turistike, ndihmon në krijimin e një përvoje të sigurt kundrejt rihapjes.

Protokollet dhe udhëzimet që ne po paraqesim këtu, janë krijuar me ndihmën e guidave lokale, ndërkohë që ata kanë hulumtuar praktikat më të mira evropiane dhe botërore, të aplikueshme në mjedisin shqiptar.

Këto protokolle janë menduar të përdoren bashkarisht me informacionet dhe manualet aktuale, të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Këto protokolle aplikohen specifikisht në aktivitetet turistike që janë më të frekuentuara në Shqipëri.

# Introduction

As the whole Travel Industry is striving toward a cautious reopening, having a set of guidelines which provide a common set of actions that can be applied to a diverse set of activities and experiences can help create a safe path toward reopening.

The guidelines are created with the help of our local guides as they had to consult various best practices applicable to the Albanian environment and local industry.

These guidelines are designed to be used together (as a supplementary material) with the Albanian Ministry of Health Protocols and are specific to the types of activities the travel industry deals most from day-to-day basis.



## I. Njësitë e vogla hoteliere:

Në Shqipëri, gjatë viteve të fundit kemi vënë re një fokus më të madh nga individë të ndryshëm, drejt kthimit të shtëpive të tyre, në njësi akomoduese për të mikpritur turistë. Kjo gjë ka krijuar mundësinë për të filluar biznese të reja, si për shembull akomodime alternative, qendra agro-turistike, si dhe bujtina që kanë në fokus turistët ndërkombëtarë.

Duke pasur parasysh këto zhvillime, bëhet e nevojshme krijimi i protokolleve apo udhëzimeve të qarta, të cilat janë krijuar nga guidat tona lokale. Këto udhëzime kanë për qëllim të ndihmojnë që njësitë akomoduese të krijojnë një kornizë veprimesh të sigurt, të cilat do të ndihmojnë në një menaxhim më të mirë të eksperiencës turistike dhe do të ulin rrezikun e transmetimit të virusit COVID-19.



## II. Menaxhimi i Grupit:

- Për shkak të natyrës së shumë njësive akomoduese që ekzistojnë në Shqipëri, rekomandohet që grupet që akomodohen në këto njësi, të jenë sa më të vogla.
- Kur kemi të bëjmë me njësi akomoduese me kapacitet të reduktuar, rekomandohet përdorim ekskluziv i njësisë vetëm nga një grup, për çdo rast rezervimi.
- Në rast se kjo gjë nuk është e mundur, atëherë duhet të ndiqet një protokoll që ndihmon në distancimin e grupeve nga njëri-tjetri, gjatë kohës që këto grupe përdorin zona të përbashkëta.
- Kur përdoret transport rajonal, ose kur grupi gjendet në një situatë ku ata janë shumë afër me njëri-tjetrin, atëhere përdorimi i maskave bëhet i domosdoshëm.



## I. Small Lodges:

In Albania, in the recent years, we see an increased focus from different households to create new business ventures and provide alternative accommodation, agritourism experiences, and guesthouse accommodation to international travelers and groups alike.

That's why having clear guidelines and protocols created by our local guides and implemented by the accommodation facilities, enhances the guest experience, and helps mitigate possible risks linked to covid-19 virus and its variants.



## II. Group Management:

- Because of the nature of most of the accommodation facilities that exist currently in Albania it is advisable to welcome only small groups.
- Ideally and especially in the case of small accommodation offering exclusive use of the facilities to minimize interaction with other groups is preferable.
- If this is not possible then consider separating the groups in communal areas in coordination with the accommodation owners and other guides.
- It is advisable as well to put all groups, when they are not part of the same household, in single rooms.
- When using transportation or when in close proximity groups or individual should use face coverings.



### III. Procedura para dhe gjatë qëndrimit të grupeve në njësinë akomoduese:

- Përpara mbërritjes së grupit ose turistëve në njësinë akomoduese, stafi lokal duhet të kërkojë nga klientët që ata të bëjnë një vlerësim paraprak të gjendjes së tyre shëndetësore.
- Është e rëndësishme t'u kërkojë klientëve që të tregojnë nëse janë vaksinuar në vendet e origjinës, apo nëse kanë tashmë një çertifikatë digjitale COVID-19.
- Stafi lokal duhet të krijojë një procedurë të përditshme kontrolli të gjendjes shëndetësore të klientëve dhe të monitorojë situatën, në mënyrë që të detektohet dhe parandalohet infektimi dhe transmetimi i COVID -19.
- Stafi lokal, por edhe pronarët e njësive akomoduese, duhet të kufizojnë ndërveprimet e tyre me klientët, duke i mbajtur këto në minimumin e mundshëm. Është e zakonshme, për shkak të kulturës së mikpritjes në Shqipëri, që të kemi kontakt fizik me turistët. Për aq sa është e mundshme, ky zakon duhet të kufizohet dhe ndërkohë, stafi dhe pronarët duhet të jenë të vëmendshëm të lajnë duart sa më shpesh.
- Dezinfektantët duhet të jenë të aksesueshëm në çdo ambient që është pronë e njësive akomoduese. Stafi lokal gjithashtu, duhet të inkurajojë përdorimin e dezinfektantëve në mënyrë të vazhdueshme nga klientët e tyre.



### IV. Transporti:

- Në mënyrë që të ulët rrezikun e transmetimit të COVID-19, të gjitha mjetet e transportit që përdoren për të transportuar turistë, duhet të kenë dritaret e hapura, në mënyrë që të sigurohet ventilimi i nevojshëm i kabinës.
- Pasagjerët duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ndaj njëri-tjetrit, si dhe të mbajnë maskë përgjatë udhëtimit.
- Drejtuesit e mjeteve duhet të pajisin mjetet e tyre me dezinfektues lehtësisht të aksesueshëm për pasagjerët.
- Guidat duhet të kujtojnë drejtuesit e mjeteve rregullisht, në mënyrë të përditshme, që të dezinfektojnë mjetin e tyre, para mbërritjes së pasagjerëve.



### III. Pre-Arrival and Check-in:

- Before the group arrival, the local staff should ask guests to self – assess their physical condition and self-screen their risk profile.
- Especially when dealing with international tourist it is important to ask them if they have been tested recently or if they have been vaccinated.
- Local staff should perform daily screening of their clients and monitor the situation in order to detect possible symptoms related to covid -19.
- Local staff and accommodation owners should limit their interaction with their guest by keeping these interactions to a minimum. It is common as part of the Albanian hospitality to shake hands with guests. If this practice is not contained somehow than at least staff should remind themselves to wash their hand frequently and wear masks continually.
- Sanitizers and washing facilities should be accessible at all times. Guests need to be reminded to use these facilities or sanitizers continually.
- It is common for local guides to hold daily briefing inside or outside of the accommodation facilities. In such cases guides must remind their guest to maintain social and physical distance.
- Handling client's luggage from local staff or guides should be followed by sanitization practices such as cleaning the frequently touched areas of a luggage and using hand sanitizers or washing facilities in the end of the activity.



### IV. Transport:

- In order to mitigate the risk of covid-19 transmission, all transportation vehicles used to transport tourist groups must have windows opened in order to provide ample ventilation.
- Provide space in between passengers and have passengers wear face covering.
- Drivers should have hand sanitizers readily available to guests and encourage its use when entering and exiting the vehicle.
- Guides need to remind their drivers daily about the disinfection of the vehicle prior to the group departure.

## **V. Dhomat:**

- Stafit lokal duhet të ketë në vëmendje të vazhdueshme dezinfektimin e dhomave, para mbërritjes së klientëve, sipas protokolleve të Ministrisë Shqiptare të Shëndetësisë
- Stafit ka përgjegjësi të identifikojë zonat që preken në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i dezinfektojë ato vazhdimisht, përgjatë ditës.
- Nëse një klient shfaq simptoma të COVID-19, stafit lokal duhet të ndjekë procedurat e mëposhtme:
  - o Nëse klienti ka temperaturë të lartë, kollë, humbje të ndjesisë së shijes apo nuhatjes, atëherë ai duhet të izolohet në një dhomë, duke mos pasur kontakt me klientë të tjerë.
  - o Autoritetet vendore duhet të njoftohen dhe t'u bëhet me dije gjendja e klientit.
  - o Ndërsa klienti përjeton simptomat e COVID-19, ai/ajo nuk duhet të përdorë asnjë hapësirë publike të njësisë akomoduese.
  - o Për këtë arsye, mjekimet, ushqimi dhe pijet, duhet të serviren në dhomë, nga stafit.
  - o Klientët me simptoma, duhet të mbajnë maskë gjatë gjithë kohës.
  - o Dezinfektimi i duarve duhet praktikuar nga kushdo që gjendet në njësinë akomoduese.

## **VI. Hapësirat e përbashkëta:**

- Në zonat publike, stafit duhet të aplikojë protokolle të zgjeruara dezinfektimi.
- Masa distancuese duhet të ndërmerren në hapësirat publike.
- Kur grupe të ndryshme qëndrojnë në të njëjtën njësi akomoduese, ata duhet të mbajnë distancë nga njëri-tjetri dhe të ndjekin protokollin e përcaktuar për dezinfektimin e duarve dhe të mjedisit përreth.
- Nëse njësi akomoduese ka një pishinë të vogël ose palestër, atëherë duhet të ndiqen patjetër, udhëzimet në lidhje me dezinfektimin e hapësirave.

## **V. Bedrooms:**

- Local accommodation staff needs to be reminded to sanitize and disinfect guest rooms in line with the Albanian Ministry of Health protocol.
- Staff should identify cleaning hot spots or high touch points and apply enhanced cleaning protocol
- If a guest shows symptoms of COVID-19 local staff needs to employ the following procedure.
  - o If a guest or local staff develops a new or worsening symptom related to covid-19 such as continuous cough or a high temperature, or loss/ change to their sense of smell or taste they need to be immediately isolated and avoid close contact with them.
  - o Call local authorities to let them know about the guest conditions
  - o While having the symptoms it is advisable not use facilities such as kitchen or public places
  - o For this reason, food, drink and medicine must be delivered to their place or room.
  - o Residents with symptoms should wear a face mask at all times
  - o Hand washing should be practiced by everyone, but especially for those with symptoms.

## **VI. Communal Areas:**

- Staff should apply enhanced cleaning protocols to communal areas
- Distancing measures need to be applied to communal areas
- When encountering other groups, please remind your group to distance themselves and follow sanitization protocols.
- If in the accommodation facility, the group is using has a small pool or gym consider using the appropriate cleaning and disinfecting protocol.



## VII. Vaktet:

- Nëse njësia akomoduese e lejon, guidat duhet të sigurojnë hapësirë të mjaftueshme për grupin, duke lëvizur karriget dhe tavolinat, në mënyrë që të krijohet distanca e sigurisë për grupin.
- Guidat gjithashtu, duhet të identifikojnë zonat që preken më shpesh nga klientët.
- Në bashkëpunim me stafin lokal, këto zona duhet të dezinfektohen vazhdimisht.
- Ushqimi dhe pijet duhet të serviren nga stafi lokal, dhe jo nga guidat apo anëtarë të grupit.
- Ushqimi duhet të shërbehet individualisht nga stafi, dhe jo të jetë në formën e një vetëshërbimi apo tavoline suedeze.
- Guidat duhet të rikujtojnë stafin që të zbatojë praktikën më të mirë, në lidhje me transportimin, ruajtjen dhe shërbimin e ushqimit.



## VIII. Informacione Shtesë:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:  
<https://shendetesia.gov.al/>



## VII. Dining:

- If the accommodation facility allows, please provide enough spacing for your group by moving seats and tables in order to create a safe environment for them.
- Identify surface contact when possible, such as high use areas and touchpoints.
- Have the local staff clean and disinfect high-use areas and touchpoints
- Food and beverages should be served by staff member who are trained
- Consider serving individual meals rather a buffet or self service
- Remind local staff to implement best practices in regard to food transportation and storage.



## VIII. Additional resources:

Ministry of Health and Social Protection:  
<https://shendetesia.gov.al/>


Përgatitur nga:



Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për  
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



**Agjencia Zvicerane për Zhvillim  
dhe Bashkëpunim SDC**

*Ky material është përgatitur nga Sondor Travel, me mbështetjen e RisiAlbania. Pikëpamjet dhe opinionet që përmbahen në të nuk përfaqësojnë ato të Qeverisë Zvicerane, as të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.*

*This material has been prepared by Sondor Travel, with the support of RisiAlbania. The views and conclusions contained here do not necessarily reflect those of the Swiss Government or the Swiss Agency for Development and Cooperation SDC*